



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2533 / Prot.

Tiranë, më 3.7. 2020

URDHËR

Nr. 201, Datë 3.7.2020

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR” NË
“INXHINIERI TELEKOMUNIKACIONI DHE RRJETI”, NË UNIVERSITETIN E
NEW YORK-UT TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 73 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Inxhinieri Telekomunikacioni dhe Rrjeti” me 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Bachelor” në “Inxhinieri Telekomunikacioni dhe Rrjeti”, në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës, në Universitetin e New York-ut Tiranë, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Inxhinieri Telekomunikacioni dhe Rrjeti”, në Universitetin e New York-ut Tiranë, fillon në vitin akademik 2020-2021.
3. Universiteti i New York-ut Tiranë të përmbushë rekomandimet e ekspertëve të jashtëm, sipas raportit të vlerësimit, bashkëlidhur këtij urdhri, përpara fillimit të veprimtarisë akademike të programit të studimit.
4. Universiteti i New York-ut Tiranë të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

5. Universiteti i New York-ut Tiranë të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti i New York-ut Tiranë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Besa SHAHINI

Nisur sa më sipër vlerësojmë se programi i studimit bachelor në "INXHINIERI TELEKOMUNIKACIONI DHE RRJETI " i paraqitur nga IAL "UNIVERSITETI NEW YORK TIRANA"

Plotëson standardet dhe kriteret për hapjen si program studimi Bachelor me rekomandimet:

- Programet e lëndëve nuk kanë një ndarje të qartë të ngarkesës në auditor për kredit ECTS. Të rishikohen programet e lëndëve dhe ndarjen e orëve mësimore në auditor në bazë të kategorive të lëndëve dhe kreditëve përkatëse (Lëndë të kategorisë B me 6 ECTS kanë një ngarkesë në auditor më të lartë se lëndë të po të njëjtës kategori por me 8 ECTS).
- Programet e lëndëve nuk kanë të përcaktuar qartë peshën dhe ngarkesën laboratorike. Të rishikohen programet e lëndëve për të përcaktuar orët në laborator të nevojshme për përvetësimin e argumentave të trajtuar. (Përcaktimi i orëve të laboratorit lejon edhe vlerësimin sasior të njafueshmërisë apo jo të ambienteve laboratorike në tërësi në nivel institucioni)
- Të rishikohet rregulltorja e programit të studimit duke specifikuar kriteret, kushtet dhe procedurat për pranimin, transferimin, ndërprerjen dhe rifillimin e studimeve. Nëse kriteret janë dinamike, të jepen anekse përkatëse dhe të specifikohen rregullat e modifikimit të tyre.
- Të rishikohet shpërndarja e lëndëve në kategori sipas VKM 41 dt. 24.01.2018. (Rishikimi i propozuar nuk prek ndarjen në përqindje për secilën kategori por shpërndan në mënyrë më logjike lëndët brenda tyre).
- Programet e lëndëve (syllabuse) duhen redaktuar dhe përshatuar më mirë në gjuhën shqipe: (ka terminologji që nuk kanë kuptim në gjuhën shqipe. Plan-programet e lëndëve në gjuhën angleze janë OK, përktimim/përshatja në gjuhën shqipe të për të dëshruar nga ana teknike).

Dhe që duhen plotësuar nga IAL "UNIVERSITETI NEW YORK TIRANA" brenda afatit të parashikuar në udhëzimin nr.1, datë 14.1.2020 të MASR.